



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport



RAPORTI Korrik - Shtator 2022
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Letërnjoftimi i shkurtër lidhur me Kulturën, Rinin dhe Sportin në Rahovec.

Komuna e Rahovecit shtrihet në pjesën veriperëndimore të Republikës së Kosovës. Është ndër qytetet më të vjetra të Kosovës, me relikte antike të trashëguara nga epokat e hershme ilire-romake, objekte të trashëgimisë arkitekturore, shpirtërore, fetare, etnologjike etj. Turizmi kulturor kryesisht mund të jetë i bazuar në trashëgimi kulturore/ arkitekturore: shtëpitë tradicionale, turizëm arkeologjik, shpella, trashëgimi arkitekturore dhe fetare. Në komunën e Rahovecit zhvillohen aktivitete të ndryshme kulturore, rinore e sportive, aktivitete muzikore, teatrale, bibliotekare, ekspozita, festivale e aktivitete të ndryshme kulturore. Aktivitete të ndryshme zhvillohen në qendrat kulturore në Rahovec, Krushë të Madhe, Hoçë të Madhe, Ratkoc, Xerxë, Drenoc e gjetkë. Biblioteka Komunale “Sulejman Krasniqi”, me degët në Krushë të Madhe, Ratkoc e Hoçë të Madhe me mbi 33.000 ekzemplarë, si qendrat sportive në Rahovec, palestra “Mizahir Isma”, terrenet e sportit në Krushë të Madhe, Xerxë, Ratkoc, Dejnë dhe në disa lagje të qytetit, ofrojnë mundësi të mira për zhvillimin e sportit e rekreacionit. Po ashtu, funksionojnë shoqëritë kulturore-artistike, grupet muzikore e artistike, shoqatat e ndryshme, një qendër rinore aktive, që zhvillojnë aktivitete në këto objekte kulturore, rinore e sportive. Ndër aktivitetet kryesore kulturore e promovuese që organizohen në komunën e Rahovecit janë; festivali i folklorit “Anadrinia Jehon” festa e Vjeljes së rrushit “Hardh Fest”, “Agrofest”, Festivali Ndërkombëtar i Poezisë, si dhe aktivitete të ndryshme periodike kulturore, rinore, sportive e promovuese.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e përbërë prej tre sektorëve: Kulturë, Rini dhe Sport, me një buxhet të caktuar, i mbulon tre fusha të rëndësishme në jetën e përditshme. Aktivitetet që i përfshin drejtoria janë: aktivitetet rinore, sportive, ruajtja e trashëgimisë kulturore, shfaqjet teatrale, muzikë, art.

- Në raport të punës janë të përfshira shumica e aktiviteteve të zhvilluara në drejtori, duke përfshirë aktivitete e projekte kapitale, në fushën e kulturës, trashëgimisë kulturore e historike, bibliotekarisë, sportit dhe rinisë.
- Personeli i DKRS-së përgjatë kësaj periudhe është angazhuar që të gjitha projekte e aktivitete të parapara të përfundohen me sukses, duke bërë përpjekje edhe për sigurim të mbështetjes financiare shtesë, përfshirë mbështetje nga niveli qendror; MKRS dhe donatorë të ndryshëm vendor e ndërkombëtar.
- Bashkëpunimi me OJQ-të, strukturat e pushtetit lokal, organizatat ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë dhe donatorë të ndryshëm, ka qenë konstruktiv dhe ka rezultuar me sukses në disa prej aktiviteteve të realizuara përgjatë kësaj periudhe.


Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport poashtu trajton kërkesat e palëve për shfrytëzimin e këtyre objekteve kulturore e sportive:

- Shtëpia e Kulturës në: Rahovec, Ratkoc, Xërxë, Krushë të Madhe dhe Drenoc.
- Bibliotekën “Sulejman Krasniqi” në Rahovec, Krushë të Madhe dhe Hoçë të Madhe.
- Stadiumin “Jahja Danuza” në Rahovec dhe fushat tjera sportive.
- Palestrën “Mizahir Isma”.

Përveq buxhetit të caktuar komunal, drejtoria ka bërë përpjekje për të gjetur edhe burime të tjera financiare përmes bashkëpunimit me OJQ, organizatat ndërkombëtare që veprojnë në vendin tonë, strukturat e pushtetit lokal, donatorë të ndryshëm, duke përfshirë edhe pushtetin qendror MKRS-në.

Çfarë kemi arritur?

Shënimet e mëposhtme përmbledhin aktivitetet kryesore dhe të arriturat e DKRS-së nga Korriku deri në Shtator të vitit 2022. Informata më të hollësishme janë dhënë në aneksin e këtij raporti, që ofron informacion të hollësishëm të veprimtarisë së DKRS-së.



AKTIVITETET E MUAJIT KORRIK

Gjatë këtij muaji Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport organizoi aktivitete të ndryshme dhe patë angazhime të ndryshme:

- Mbledhje zyrtare me stafën e DKRS-së, shqyrtimi i kërkesave, lëndëve dhe përgjigjjen e tyre në kopje fizike dhe në intranet.
 - Në kompleksin memorial në Gradish është bërë vendosja e kamerva.
 - Fillimi i punimeve për rregullimin e parkut në fshatin Nagavc.
 - Inspektimin e punëve në kuadër të DKRS-s.
 - Punët e përditëshme në Drejtori.
 - Përrurimi i “Kompleksit Sportiv” te Maja e Shkodranit
 - Fillimi i punimeve të terrenit sportiv në fshatin Gexhe
 - Përrurimi i fazes së parë të panelave solar me kapacitet 10kwv në Palestren e sportit “Mizahir Isma”
 - Është bërë draft agjenda për aktivitete si dhe pregaditja e broshurave për Muajin e Mërgimtarve .
 - Punimet tekë shtëpia Muze e Ukshin Hotit në Krushë të Madhe.
 - Mirëmbajtja e hapsirave publike, tereneve sportive dhe parqet të cilat janë në kuadër të DKRS-së
- **Për nder të “Epopes së Korrikut 1998”,** Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ka përcjellur dhe organizuar aktivitete përkujtimore, në bashkëpunim me organizatën e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës-dega në Rahovec.
- Homazhe te Muri i Pikëllimit dhe vendrëniet e dëshmorëve: Abdullah Bugari dhe Gëzim Hamza-Piktori-Rahovec.
 - Homazhe te vendi i betejës – Përmendorja e dëshmorëve në Fortesë.
 - Homazhe te lapidari i dëshmorëve në rrugën “UÇK” (transiti Rahovec-Malishevë).

- Homazhe te shtatorja e Shejh Myhedin Shehut- te Teqeja e Madhe e Halvetive –Rahovec.
- Homazhe te lapidari – Popma Teuta-Rahovec.
- Homazhe për dëshmoret te kompleksi përkujtimor “Maja e Shkodranit” Rahovec.
- Instalimi i kamerave është bërë në kompleksin memorial në Gradish, shtëpinë muze Ukshin Hoti dhe shtëpinë e kulturës “Muhamet Malsori” në Krushë të Madhe.
- Më 15 korrik 2022 kanë filluar aktivitetet për muajin e mërgimtarëve sipas agjendës.
- Punimet tek stacioni i Autobusave për rregullimin e parkut.
- Shqyrtimi i kërkesave, lëndëve të qytetarëve dhe përgjigjen e tyre në kopje fizike dhe në intranet.
- Punimet në Krushë të Madhe për rregullimin e aneksit tek shtëpia e kulturës.
- Inspektimin e punëve në kuadër të DKRS-s.
- Punët e përditëshme në Drejtori.

Disa nga aktivitetet kyqe të zhvilluara gjatë muajit Korrik



Përrurimi I fushës së basketbollit “Maja e Shkodranit”



Aktiviteti "Sofra e Mërgimtarit në Drenoc"



Aktivitetet Sportive në Ditën e Epopesë së Korrikut

- ❖ Manifestimet kulturore e përkujtimore në shënim të Epopesë së Korrikut.






AKTIVITETET E MUAJIT GUSHT

Gjatë këtij muaji Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport organizoi aktivitete të ndryshme dhe patë angazhime të ndryshme:

- Organizimi i aktiviteteve për muajin e mërgimtarëve sipas agjendës, është mbajtur koncert me datë 26.7.2022 në Qytet dhe me datë 28.7.2022 është mbajtur aktiviteti “Sofra e Mërgimtarit” në Drenoc
- Është bërë riparimi fushës së tenisit të shkollës mesme “Xhelal Hajda”
- Vazhdimi i tereneve sportive në fshatrat Reti e eperme, Celinë dhe Gexhë
- Promovimi i monografisë “Deri në frymën e fundit” për dëshmorin Skender Gashi, të autorit Qemajl Krasniqi.
- Më 02.08.2022, është mbajtur aktiviteti “Sofra e mërgimtarit” në Krushë të Madhe
- Fillimi i punimeve për rregullimin e parkut në fshatin Nagvc.
- Inspektimin e punëve në kuadër të DKRS-së.
- Më datë 9.08.2022 në Ratkoc është mbajtur koncert “04 BAND”,
- Më 15.08.2022 është mbajtur Koncerti përfundimtar i Muajit të Mërgimtarëve
- Është bërë vendosja e kamerave në shtëpinë e Kulturës në Ratkoc.
- Në stadionin e futbollit “Jahja Danuza” janë duke u rregulluar kabinat për vendosjen e varit, është kërkesë e Federatës së Futbollit.



Aktivitetet të zhvilluara gjatë muajit Gusht:



Aktivitete Kulturore në kuadër të aktiviteteve “Muaji i Mërgatës”

AKTIVITETET E MUAJIT SHTATOR

Gjatë muajit shtator ne si Drejtori e Kulturës, Rinisë dhe Sportit kemi kryer këto aktivitete:

- Më 03 shtator në kauder të “Hardh Festit”, është organizuar Hardh Mini Maratona në bashkëpunim me SH-L Kosova.
- Me datë 25.9.2022 në Qendren e Kulturës “Mensur Zyberaj” është mbajtur Festivali mbarëkombëtar i këngës për fëmijë “Kokrrat e rrushit këndojnë” ku kanë marrë pjesë 18 solist nga Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut.
- Me datë 24.9.2022 në fshatin Nagavc kanë filluar punimet për rregullimin e parkut të fshatit.
- Inspektimi i punimeve në Celinë punimet janë në përfundim e sipër ku shumë shpejt do të jetë e gatshme përurimi i fushës.
- Më 15 shtator 2022 është bërë përurimi i fushës së sportit në fshatin Reti e Poshtme
- Punimet te Kompleksi sportiv: Janë duke u zhvilluar ku aktualisht është në përfundim edhe pjesa tjetër e themelit.
- Punimet te stacioni i Autobusave: Ka përfunduar vendosja e kubzave, tani janë duke punuar në rregullimin e harqeve sipas projektit.

Disa nga aktivitetet kyqe të zhvilluara gjatë këtij muaj





RAPORTI I BIBLIOTEKES KOMUNALE "SULEJMAN KRSNIQI"

Biblioteka Komunale "Sulejman Krasniqi" - Rahovec - Dega në Krushë e Madhe dhe Ratkoc
Raport i punës për muajin Korrik 2022

Sektori i huazimit të librit:

Janë regjistruar: Anëtar 54, Sh.Fillore 43, Sh.Mesme 4, Student 6, Të tjerë 1.
Djem 15, Vajza 39.

Me pagesë 54, Falas 2.

Shërbime me libra: 297, Djem 98, Vajza 199.

Sallën e leximit e kanë shfrytëzuar 86 përdorues.

Pasurimi i fondit librar: 5 ekzemplar.

Dhuratë nga Autori Sabahajdin Cena me 1 tituj, 5 ekzemplar.

Fondi total i librave në bibliotekë: 25335 ekzemplar.

Anëtarësia dhe libra të lexuara në bibliotekë për muajin Korrik

Muaji	Anëtar	Me pagesë	Falas	Libra të lexuara	Djem	Vajza
Korrik	54	52	2	297	98	199

Tabela e lexuesve për muajin Korrik

Muaji	Sh.Fillore	Sh.Mesme	Student	Të tjerë	Djem	Vajza	Gjithsej
Korrik	43	4	6	1	15	39	54

Aktivitetet:

Me datë: 03.07.2022 Kemi pasur bibliotekën në Krushe të Madhe me 7 ekzemplar.

Me datë: 05.07.2022 Gazetari shumëvjeçar Shaip Shala i dhuroi bibliotekës komunale "Sulejman Krasniqi, rreth 150 numra të gazetës "Koha ditore" të periudhës 1998/99. Gazetat ishin koleksionuar dhe ruajtur me pasion nga gazetari Shala, i cili vendosi që nga sot ky koleksion të bëhet pasuri e bibliotekës publike komunale. Po ashtu, Shaip Shala i dhuroi bibliotekës edhe disa libra për gazetarinë. Materiali i dhuruar përbën interes të veçantë për personat që dëshirojnë të hulumtojnë rreth periudhës së luftës së UÇK-së në Kosovë. Të interesuarit mund ta shfrytëzojnë këtë arkiv të pasur, si dhe mund të kenë qasje edhe në arkivin shtetëror të Shqipërisë dhe të Kosovës nga biblioteka komunale "Sulejman Krasniqi". Në shenjë falënderimi e mirënjohjeje, drejtori i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport Afrim Dina i dhuroi një mirënjohje komunale gazetarit Shaip Shala, në shenjë vlerësimi të punës së tij shumëvjeçare në gazetari.

Me datë: 12.07.2022 Profesor Dr. Sabahajdin Cena i dhuroi bibliotekës komunale "Sulejman Krasniqi" disa ekzemplarë të librit të tij "Kronikë nëpër stuhi".

Në këtë vëllim janë përmbledhur të dhëna jetësore për dëshmorët e kombit të rënë në periudhën janar - mars 1998/99 në luftë për çlirimin e trojeve të pushtuara shqiptare. Profesori Cena planifikon që libri i tij "Kronikë nëpër stuhi" të dalë në katër vëllime, ku do të përfshihen të gjithë dëshmorët të rënë në luftën çlirimtare varësisht nga periudha kur kanë rënë, duke përmblytur kështu kornizën kohore të ndarë në çdo tre muaj. Përmbledhjen e parë e ka ndihmuar financiarisht Komuna e Rahovecit, ndërsa Profesori i ka gati edhe vëllimet tjera që pritet të dalin në dritë varësisht nga kontributi financiar i donatorëve apo institucioneve lokale e qendrore.

Profesorit Sabahajdin Cena i dëshirojmë shëndet dhe e falënderojmë për pasurimin e fondit librar të bibliotekës komunale "Sulejman Krasniqi"!

Biblioteka Komunale "Sulejman Krasniqi" - Rahovec - Dega në Krushë e Madhe dhe Ratkoc
Raport i punës për muajin Gusht 2022

Sektori i huazimit të librit:

Janë regjistruar: Anëtar 67, Sh.Fillore 56, Sh.Mesme 6, Student 3, Të tjerë 2.

Djem 20, Vajza 47.

Me pagesë 66, Falas 1.

Shërbime me libra: 381, Djem 128, Vajza 258.

Sallën e leximit e kanë shfrytëzuar 136 përdorues.

Pasurimi i fondit librar: 0 ekzemplar.

Fondi total i librave në bibliotekë: 25335 ekzemplar.

Anëtarësia dhe libra të lexuara në bibliotekë për muajin Gusht

Muaji	Anëtar	Me pagesë	Falas	Libra të lexuara	Djem	Vajza
Gusht	67	66	1	381	128	258

Tabela e lexuesve për muajin Gusht

Muaji	Sh.Fillore	Sh.Mesme	Student	Të tjerë	Djem	Vajza	Gjithsej
Gusht	56	6	3	2	20	47	67

Aktivitetet: Gusht

Me datë: 23.08.2022 Në Këndin Amerikan, patëm një takim me mësues dhe menaxherë nga bibliotekat rajonale, në përgatitje të fillimit të programit të ri "English club for young leaders"

Në kuadër të AMERICAN CORNER- PRIZREN, orgaiznohet kursi i gjuhës angleze për të rinjë. Kursi zgjat 2 muaj, fillon prej datës 20 Shator deri me 20 Nëntor. Numri është i kufizuar 15-20 kandidat dhe atë prej moshës 18-30 vjeçar.

Kursi do të mbahet në Bibliotekën Komunale "Sulejman Krasniqi" Rahovec dy herë në javë.

Tematika e kursit është LIDERISHIPI PËR TË RINJË, ku do të zhvillohen, debate, diskutime,

prezantime, takime dhe aktivitet të ndryshme në kuader të këtij programi dhe atë në gjuhën angleze.

Kursi është falas dhe në fund të projektit do të çertifikohen të gjithë kandidatet nga Ambasada Amerikane- Prishtinë.

Biblioteka Komunale “Sulejman Krasniqi” - Rahovec - Dega në Krushë e Madhe dhe Ratkoc

Raport i punës për muajin Shtator 2022

Sektori i huazimit të librit:

Janë regjistruar: Anëtar 30, Sh.Fillore 17, Sh.Mesme 5, Student 5, Të tjerë 3.
Djem 7, Vajza 23.

Me pagesë 30, Falas 0.

Shërbime me libra: 209, Djem 54, Vajza 155.

Sallën e leximit e kanë shfrytëzuar 116 përdorues.

Pasurimi i fondit librar: 5 ekzemplar.

Dhuratë nga Autorja Hanëmshahe Ilazi me 1 tituj, 5 ekzemplar.

Fondi total i librave në bibliotekë: 25340 ekzemplar.

Anëtarësia dhe libra të lexuara në bibliotekë për muajin Shtator

Muaji	Anëtar	Me pagesë	Falas	Libra të lexuara	Djem	Vajza
Shtator	30	30	0	209	54	155

Tabela e lexuesve për muajin Shtator

Muaji	Sh.Fillore	Sh.Mesme	Student	Të tjerë	Djem	Vajza	Gjithsej
Shtator	17	5	5	3	7	23	30

Aktivitetet: Shtator

Me datë: 05.09.2022 Kemi marrë pjesë në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës “Pjetër Bogdani”, ku ka filluar “Java e Bibliotekës në Kosovë”, edicioni i 19-të me radhë që do të zgjasë deri më 11 shtator.

Tema bosht e këtij edicioni është: ‘Dokumentimi i kulturës së emigracionit : koleksionet e shtypura dhe digjitale’, duke u synuar kontribuimi në procesin e dokumentimit të trashëgimisë së emigracionit.

Brenda kësaj jave do të ketë aktiviteteve të ndryshme kulturore e bibliotekare, sesione shkencore nga bibliotekaria, komunikimi, historia, teknologjia informative, referencat, digjitalizimi etj.

Java e Bibliotekës organizohet nga Biblioteka Kombëtare e Kosovës, në bashkëpunim me Shoqatën e Bibliotekarëve të Kosovës dhe mbështetet nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Biblioteka Komunale “Sulejman Krasniqi” është pasuru me pesë (5) ekzemplar të ri, titulli A vriten engjëjt ?! (Vrasjet e fëmijëve në Kosovë) (1981- 2000) dhurat nga autorja Hanëmshahe Ilazi.

Me datë 22.09.2022 Programi i klubit të anglishtes për liderët e rinj filloi me sukses në pesë komuna, Prizren, Suharekë, Dragash, Malishevë dhe Rahovec.

Programi i udhëheqësve të klubeve angleze synon të frymëzojë dhe të nxisë diskutime rreth temave që ndikojnë në komunitet dhe anëtarët e tij. Programi synon të ofrojë strategji për krijimin dhe mbajtjen e një klubi anglez duke ofruar ide që do të motivojnë dhe inkurajojnë njerëzit të praktikojnë aftësitë e tyre në gjuhën angleze dhe të krijojnë ndryshime pozitive në komunitetet e tyre. Fokusi i këtij programi është praktikimi i gjuhës angleze, ndërsa mësohet edhe për historinë, gjeografinë dhe vlerat e SHBA-së. Në pesë komuna do të ketë një seri takimesh të planifikuara rregullisht ku anëtarët do të praktikojnë anglisht dhe do të ndihmojnë komunitetin në zgjidhjen e problemeve.

Këto klube mbështeten nga Abasada Amerikane në Prishtinë.



PËRFUNDIMI

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, përveç aktiviteteve të parapara për periudhën kohore Korrik-Shtator 2022 është angazhuar në aktivitete dhe punë të ndryshme si:

- Pranimi dhe shqyrtimi i lëndëve;
- Vizitë objekteve sportive;
- Takime me klube dhe shoqata sportive;
- Vizitë objekteve kulturore;
- Takim me rini dhe shoqata e organizata rinore;
- Organizimi i aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive;
- Monitorimi i aktiviteteve të subvencionuara nga DKRS-ja;
- Takime të rregullta në kuadër të DKRS-së;

Rahovec, tetor 2022



Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
Afrim Dina

